REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit 02
Nr.Prot: / Broj Prot. / Prot No. 05-4791
Nr.i faqave / Br.stranica / No.pages -4-
Data: / Datum: / Date: 08/07/2026
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE/PSO

EMRI I PSO: TRANSPORTI I MOSTRËS SË FECESIT PËR EKZAMINIMIN MIKROSKOPIK TË PARAZITEVE TË TRAKTIT DIGJESTIV (ITG02/V1.0)

PËRMBAJTJA: DOKUMENTI PËRFSHIN HAPAT KRYESORË PËR TRANSPORTIN E MOSTRËS SË FECESIT PËR EKZAMINIM MIKROSKOPIK TË PARAZITEVE TË TRAKTIT DIGJESTIV, DUKE SIGURUAR QË TESTIMI TË KRYHET NË MËNYRË TË SAKTË DHE TË STANDARDIZUAR.

VERSIONI: 1.0.
DATA E APROVIMIT: 07.07.2026
AUTOR: MSH/IKSHPK
NR. I HAPAVE: VI
NR. I NËNHAPAVE: 22

APROVUAR: Jahë Gecaj
U.D. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë

V.V

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA - QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA - MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - MINISTRY OF HAELTH - Prishtinë / a

QËLLIMI	QËLLIMI I KËSAJ PSO ËSHTË TË SIGUROJË NJË QASJE TË STANDARDIZUAR PËR PROCESET E TRANSPORTIT TË MOSTRËS SË FECESIT PËR EKZAMINIMIN MIKROSKOPIK TË PARAZITEVE TË TRAKTIT DIGJESTIV PROCEDURA E PËRSHKRUAR DUHET TË ZBATOHET NGA GJITHË PERSONELI LABORATORIK.
NDËRLIDHJA ME AKTET	• LIGJI NR. 08/L-200 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE, • PLANI STRATEGJIK KOMBËTAR PËR LABORATORE 2024-2030; • DORACAKU PËR MENAXHIMIN E CILËSISË NË LABORATORË.
LISTA E SHKURTESAVE	• PSO - PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE; • PPM - PAJISJET PERSONALE MBROJTËSE; • ITG- INFEKSIONET E TRAKTIT GASTROINTESTINAL.

PROCEDURA

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Zbatimi i masave për menaxhim të mostrave	1. Mostra merret nga infermieri në klinikë ose dërgohet nga vet pacienti në zyrën e pranimit; 2. Etiketimi i menjëhershëm me emrin ose kodin e pacientit, datën dhe orën e marrjes; 3. Verifikimi i përputhshmërisë së të dhënave të pacientit me formularin e kërkesës; 4. Mostra transportohet nga laboranti në zyrën e pranimit deri në laboratorin e Infeksioneve të Traktit gastrointestinal; 5. Rezultati analizohet nga laboranti dhe mjeku përkatës; 6. Rezultati aprovohet nga mjeku përgjegjës; 7. Laboranti kryen pranimin dhe refuzimin e mostrës duke i respektuar kriteret e pranimit të mostrës në bazë të Doracakut për Cilësinë e punës në laborator.
[II]	Materialet e nevojshme për transport	1. Materialet që janë të nevojshme: a. Kontejner i pastër për mostër; b. Sondë ose spatulë; c. Medium transporti (Formalin, nëse kërkohet); d. Dorëza Nitrile një përdorimëshe S,M, L; e. Qese Biohazard dhe laps-ngjyrë e përhershme; majë e dyfishtë; f. Pajisjet Personale Mbrojtëse (PPM).
[III]	Veprimet e marrjes, përgatitja e pacientit dhe transportit të mostrës	1. Përgatitja e pacientit: a. Pastroni mirë zonën perianale; b. Mos përdorni detergjent, sapunë aromatikë, ose antiseptikë në zonën perianale (mund të ndikojë në rezultatet); c. Evitohet urinimi në mostër, prandaj pacienti duhet të zbrazë fshikëzën para mbledhjes nëse është e mundur; d. Nuk rekomandohet mbledhja pas përdorimit të klizmave ose medikamenteve të veçanta pa udhëzimin e mjekut, pasi mund të ndikojë në mikrobiotën ose parazitët; 2. Periudha kohore e marrjes së mostrës: a. Mostra ideale, feces i freskët, i marra menjëherë pas zbrazjes; b. Nëse nuk mund të transportohet menjëherë, përdoret medium transporti ose ruhet në frigorifer (2–8°C); 3. Marrja e mostrës: a. Përdorimi i materialeve sterile; b. Doreza njëpërdorimëshe; c. Spatulë ose sondë e siguruar me kontejnerin; 4. Mbledhja e mostrës: a. Merrni një sasi të vogël (5–10 gram) nga pjesa e mesme të fecesit;

		b. Shmangni kontaktin me urinën, ujë ose letër higjienike; 5. Vendosja në kontejner: a. Vendoseni mostra në kontejnerin steril ose të pastër; b. Mbyllni kapakun hermetikisht; 6. Përgatitja për transport: a. Etiketimi i kontejnerit; b. Emri i pacientit; c. Data dhe ora e marrjes; d. Lloji i analizës.
[IV]	Veprimet e mbrojtjes dhe siguria e mostrës	1. Vendoseni kontejnerin në qese plastike të mbyllshme; 2. Nëse dërgohet në laborator jashtë klinikës, përdor paketim të dyfishtë sipas rregullave të transportit të mostrave biologjike; 3. Kushtet e transportit: a. Transport i shpejtë: temperatura e dhomës, analizë brenda 2–3 orësh; b. Transport i gjatë: përdoreni medium transporti ose ruani në frigorifer (2–8°C) ; c. Shmangni ekspozimin ndaj diellit ose nxehtësisë.
[V]	Veprimet laboratorike të ekzaminimit mikroskopik	1. Përgatitja e mostrës për ekzaminim mikroskopik: a. Merrni një sasi të vogël të fecesit (rreth madhësia e një bizele ose 1–2 g); b. Vendoseni në një tabaka ose enë të vogël; c. Shtoni një sasi të vogël e ujë të pastër ose tretje fiziologjike për të bërë një suspension të homogjenizuar; 2. Ekzaminimi mikroskopik direkt: a. Vendosni një pikë të vogël të mostrës në lamën mikroskopike. b. Shtoni një pikë të vogël të ujit ose ngjyrosës (p.sh., lugol) për të rritur kontrastin; d. Vendosni mbulesën e qelqit dhe ekzaminoni në mikroskop në 10x dhe pastaj në 40x për të identifikuar: • Cistët e protozoave (p.sh., *Giardia*, *Entamoeba histolytica*). • Oocistet e cisticercus dhe helminteve. • Larvat ose vezët e krimba të ndryshëm.
[VI]	Veprimet laboratorike të raportimit të rezultatit	1. Interpretimi i rezultatit: 1.1. Rezultati mund të jetë pozitiv ose negativ; a. Nëse pozitiv: Specifikoni parazitin. b. Nëse negativ: Raporti nga Medlis "Ne ekzaminim direkt mikroskopik nuk vërehen forma cistike as vezë të parazitit" ; 2. Raporti duhet të jetë i firmosur nga personi që ka kryer ekzaminimin dhe nga përgjegjësi i laboratorit; 3. Raporti mund të jepet në format elektronik ose të printuar, sipas protokollit të institucionit dhe akteve tjera në fuqi